

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Analiza: Çfarë mund të ndodhë me shtatë figurat e UÇK-së që u përmendën në aktgjykimin e 16 shtatori t?
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/analiza-fare-mund-te-ndodhe-me-shtate-figurat-e-uk-se-qe-u-p-ermenden--i514777
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 07:40:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 07:22:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4340141eeda92f84c0205b022f6fa5bdc5cf2eb3269611d8ca36ec245868168e
TEKSTI	f7852c7cd0a726799d9281955433410472a0665e023eca61b5140062feb6ca80
PAMJA	545319ab68e74836c82fef2cd7e70a89e2ebb5e52789f67d7b20b0993b55c7a9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c2044edc37c706d061f24480c45e8d89e7843117a8178bf39728ca9ee960f497
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	401dcacf3311c18d7b93cbabfd522e0d009d4ac62bab22fd89058a16395500d64
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c2044edc37c706d061f24480c45e8d89e7843117a8178bf39728ca9ee960f497>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

13 ORE ME PARE

110 ditë qëndresë/ Pas protestës para Kuvendit qytetarët mbledhen sërish në Bulevard: Arrestoni Ramën!

18 ORE ME PARE

Vendimi i Hagës nxiti protesta dhe reagime në Kosovë/ PDK mbledh Kryesinë, familjarët: Gjykatë kriminale, presim pafajësi në Apel

23 ORE ME PARE

Pagat e magistratëve, PS propozon rritje sa 2% e pagës së Presidentit! Rama shkon në Kuvend. Bardhi: Puç kushtetues

23 ORE ME PARE

"Nuk na përfaqësoni"/ Qytetarët protestojnë pranë Kuvendit, përplasen me policinë, shoqërohen disa prej tyre

Aktualitet

Analiza: Çfarë mund të ndodhë me shtatë figurat e UÇK-së që u përmendën në aktgjykimin e 16 shtatorit?

Trupi gjykues e mbështeti ekzistencën e "qëllimit të përbashkët kriminal" në faktorë si: vrasjet e shqiptarëve të dyshuar si kolaboracionistë dhe të serbëve, komunikatat politike, luftën speciale, qendrat e ndalimit dhe tolerancën, pranimin dhe inkurajimin e krimeve ndaj kundërshtarëve.



18 Shtator 2026, 09:22
Nga E.d



Flamuri i UÇK-së shihet afër ndërtesës së Qeverisë së Kosovës

Lahi Brahimaj, Fatmir Limaj, Sylejman Selimi, Rustem Mustafa, Latif Gashi, Shukri Buja dhe Sabit Geci nuk ishin të pandehur, por emrat e tyre u përmendën në aktgjykimin e 16 shtatorit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Gjatë shpalljes së verdiktit dënues për krime lufte ndaj katër ish-eporëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), trupi gjykues i asaj që njihet edhe si Gjykata Speciale konstatoi se shtatë figurat tjera ishin anëtarë të "ndërmarrjes së përbashkët kriminale".

Madje, u tha se Limaj, Geci, Mustafa dhe Gashi "ishin zbatues të zellshëm të qëllimit kriminal që kishte në shënjestër kundërshtarët".

Si e përshkroi Specialja "ndërmarrjen e përbashkët kriminale"?

Trupi gjykues e mbështeti ekzistencën e "qëllimit të përbashkët kriminal" në faktorë si: vrasjet e shqiptarëve të dyshuar si kolaboracionistë dhe të serbëve, komunikatat politike, luftën speciale, qendrat e ndalimit dhe tolerancën, pranimin dhe inkurajimin e krimeve ndaj kundërshtarëve.

Sipas gjyqtarëve, katër ish-udhëheqës të UÇK-së i kishin caktuar vetes dhe të tjerëve role e pozita, përmes të cilave "kontrolluan zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal".

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 09:22

Analiza: Çfarë mund të
ndodhë me shtatë figurat e
UÇK-së që u përmendën në
aktgjykimin e 16 shtatorit?

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 07:21

Gati gjysma e shqiptarëve
kanë vështirësi të mbyllin
muajin, e dyta në Europë

"Kriminalizim retrospektiv" i udhëheqjes së UÇK-së

Ish-prokurori i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), Geoffrey Nice, e quan "të paprecedentë" mënyrën se si Brahimaj, Limaj, Sylejman Selimi, Mustafa, Gashi, Buja dhe Geci u emërtuan në aktgjykimin ndaj katërshes së UÇK-së.

Në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë (REL), ai tregon se në aktgjykime të tilla mund të thuhet se dikush ka "vepruar në kuadër të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale me persona të panjohur".

Ndërkaq, avokati i licencuar në Dhomat e Specializuara, Artan Qerkini, thotë për REL-in se trupi gjykses kishte nevojë për "anëtarë" të tjerë si pjesë e këtij "qëllimi të përbashkët", për t'i lidhur katër të dënuarit me krimet e kryera nga persona të tjerë.

Me këtë konstatim, sipas Nevenka Trompit, hulumtuese e TPNJ-së që ka ndjekur nga afër edhe procesin në rastin "Thaçi dhe të tjerët", Gjykata Speciale e cilësoi gjithë Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së si pjesëmarrës në "ndërmarrje kriminale".

"Është një kriminalizim retrospektiv i strukturës qendrore komanduese të UÇK-së si tërësi, në një shkallë që aktgjykimet e vetë TPNJ-së nuk e vërtetuan kurrë", thotë Tromp për REL-in.

A mund të nisë Prokuroria hetime ndaj shtatëshes?

Në një përmbledhje të aktgjykimit të 16 shtatorit thuhet se shtatë figurat e UÇK-së ranë dakord "për qëllimin e përbashkët kriminal", por theksohet se atyre nuk u është konstatuar fajësia dhe se gëzojnë prezumimin e pafajësisë.

Edhe avokati Qerkini pohon se fakti që ata përmenden në aktgjykim nuk përbën kallëzim penal për ta.

"Zyra e Prokurorit të Specializuar i ka pasur këta emra në aktakuzën e vet që nga viti 2020, dhe për gjashtë vjet nuk ka ngritur aktakuzë ndaj tyre", thotë ai.

Pikëpyetjen nëse shtatë të përmendurit mund të përballen me pasoja juridike, Qerkini thotë se "e mbyll përfundimisht" rasti i Sylejman Selimit, ngase Zyra e Prokurorit të Specializuar i kishte ndërprerë hetimet ndaj tij në shkurt të vitit 2025.

Sipas tij, edhe emrat e tjerë kanë kaluar nëpër procese gjyqësore, dhe këtu thotë se vlen parimi i njohur i të drejtës penale "Jo dy herë gjykim për të njëjtën çështje".

Javë më parë, nga Prokuroria Speciale i thanë REL-it se nuk pranojnë të komentojnë mbi "ekzistencën ose hollësitë e ndonjë hetimi".

Sipas tyre, mandati i kësaj prokurorie vazhdon "derisa Këshilli i Bashkimit Evropian të njoftojë institucionet e Kosovës se hetimet dhe procedurat përkatëse kanë përfunduar".

Shukri Buja, i përmendur nga trupi gjykses më 16 shtator, nuk beson se mund të ndiqet, pasi prokurorët e Speciales në vitin 2024 mbyllën hetimet që i kishin nisur ndaj tij pesë vjet më herët.

"Jam rasti i parë që i kanë mbyllur hetimet, dhe në njëfarë forme e kanë shpallur luftën time të drejtë dhe të panjollësuar", shprehet Buja për REL-in.

Ai thotë se nuk e njollos as emërtimi "anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale", ndryshe nga aktgjykimi që, sipas tij, "padrejtësisht" njollosi katër ish-krerët e UÇK-së.

Nëpër çfarë procese kaluan shtatë figurat e UÇK-së?

Disa nga shtatë figurat e përmendura në aktgjykim janë marrë në pyetje nga Prokuroria e Specializuar në Hagë.

Më herët, ata kanë pasur përvojë të ndryshme me drejtësinë për çështje që lidhen me krimet e luftës.

Lahi Brahimaj dhe Fatmir Limaj u gjyquan nga TPNJ-ja, por të dy përfundimisht u shpallën të pafajshëm. Limaj u shpall gjithashtu i pafajshëm në rastet "Kleçka" dhe "Bellanica" në Kosovë.

Sylejman Selimi, Rustem Mustafa dhe Latif Gashi u dënuan nga gjykatat në Kosovë për krime lufte, ndërsa Selimi më vonë u shpall i pafajshëm në rigjykimin e njërit prej rasteve.

Sabit Geci u dënu në Kosovë për krime lufte ndaj civilëve, ndërsa Buja nuk ka kaluar nëpër ndonjë proces

BOTA 18 SHTATOR 2026, 07:15

Hetimet për nënshkrimet e partisë/ Parlamenti European i heq imunitetin eurodeputetes greke Afroditi Latinopoulou

më të klikuarat

Regjistruan 1143 hektarë me dokumente false/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pranga edhe një punonjës (EMRAT)

Falsifikime dhe shpërdorim detyre/ Pezullohen dy zyrtarë në Tiranë, shpallet në kërkim shqiptaro-izraeliti me tre identitete

Shkatërrohet organizata shqiptare që frymëzoi serialin e famshëm 'Marbella'/ Kapen 2.7 ton kokainë, sekuestrohen dy armë zjarri dhe 29 mjete luksoze, 15 persona të arrestuar (VIDEO)

Kontrolle në burgjet e Peqinit dhe Fierit/ Kapen celularë, arrestohet një i burgosur dhe procedohen 9 persona

insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by  tomorrow.

gjyqesor per krime lulte.

Sipas ish-prokurorit Nice, duhet pritur aktgjykimin e plotë për të parë nëse do të ketë një arsytim pse u përmendën shtatë emrat në rastin ndaj katërshe së UÇK-së./REL

uÇk16 shtatori shtatë figurat

Sondazh

Poll

Aktualitet18 Shtator 2026, 08:47

Blokimi i pagave të magjistratëve/ Drejtoresha e Thesarit, Elmira Peto merret në pyetje nga SPAK

Foto ilustruse TIRANA- SPAK ka marrë në pyetje drejtoreshën e Thesarit, Elmira Peto, në lidhje me bllokimin e pagave të ...

"Ju erdhi fundi"/ Sot dita e 111-të e protestës, qytetarët të vendosur deri në largimin e qeverisë: Rama, jep dorëheqjen!

Aktualitet18 Shtator 2026, 08:45

"Mrekullia" e eksporteve zgjat vetëm një muaj, fasoni rënie e pandalshme, zbret në grupin e dytë

Aktualitet18 Shtator 2026, 07:32

Gati gjysma e shqiptarëve kanë vështirësi të mbyllin muajin, e dyta në Europë

Aktualitet18 Shtator 2026, 07:21

"Taksë e fshehtë" mbi naftën për rezervën e sigurisë, do të rritet çmimi, e pranon dhe qeveria

Aktualitet

18 Shtator 2026, 07:12

Aktualitet

18 Shtator 2026, 07:09

Kushte atmosferike të qëndrueshme, parashikimi i motit për sot

Foto ilustruese TIRANA- Sot vendi ynë do të ndikohet nga kushte atmosferike të qëndrueshme. Moti parashikohet i kthjellët si dhe VI...

Në Prishtinë protestohet kundër vendimit të Speciales: Do të vazhdojmë pa ndalur

Aktualitet

17 Shtator 2026, 22:57

110 ditë protestë/ Mbyllet revolta te Komisarati nr.1: Lironi çunat, arrestoni Ramën

Aktualitet

17 Shtator 2026, 22:55

Protesta e 110-të kundër qeverisë/ Qytetarët rrethojnë komisaratin nr.1, thirrje: Lironi çunat(VIDEO)


Aktualitet

17 Shtator 2026, 22:50

Sherri mes të rinjve në Sarandë/ Dalin PAMJET nga vendi i ngjarjes, njëri prej autorëve tenton t'i ngulë thikën në qafë...

Aktualitet

MË SHUMË



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.